


ANALIZA E GJENDJES ME KRIJIMIN E SHKATHTËSIVE TË GJELBRA REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

“Përgatitja e hulumtimit për shkathtësi ‘të gjelbra’ dhe potenciali i tyre në arsimin e mesëm të Maqedonisë së Veriut”



Prof. Dr. Pece Nedanovski
Prof. Dr. Natasha Danilloska

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Njeriu bashkëkohor ballafaqohet me shumë sfida. Njëra nga më të rëndësishmet është sfida e fitimit të shkathtësive të reja me të cilat do të kontribuojë në ruajtjen e cilësisë së rrethuar të mjedisit jetësor dhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Bëhet fjalë për prodhim më efikas me emisione më të ulëta të CO₂, si dhe për prodhim të sasive më të mëdha të energjisë nga burime të rinovueshme. Në këtë mënyrë jepet kontributi përkatës në procesin e gjelbërimit të ekonomisë dhe krijimin e bazës për qëndrueshmërinë e saj. Në këtë drejtim duhet të analizohet dukuria e shkathtësive të gjelbra që do të përputhen me ndryshimet dhe proceset aktuale, por edhe me vendet e reja të gjelbra të punës. Shkathtësitë e gjelbra duhet gradualisht të kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe ripërtëritjen e cilësisë së mjedisit jetësor dhe shmangien e dëmtimit të eko-sistemeve në të ardhmen.

Shkathtësitë e gjelbra vendosin spektër të gjerë të kualifikimeve, arsimimit dhe shkathtësive. Ato nuk ekzistojnë vetëm në sektorin privat por edhe në atë publik, si dhe në fushën e institucioneve shkencore dhe akademike, shoqatave profesionale etj. Shkathtësitë e gjelbra janë shkathtësi në funksion të sigurimit të produkteve ose shërbimeve që përmirësojnë efikasitetin energjetik, zgjerojnë shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë ose paraqesin përkrahje për qëndrueshmërinë ekologjike. Këto shkathtësi paraqesin bazë për kryerje të punës në kategoritë e shumta të veprimtarisë së gjelbër ekonomike: shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe lëndëve djegëse alternative; efikasiteti energjetik; udhëheqja, parandalimi dhe ulja e ndotjes, mbeturinave dhe gazrave serrë; pastrimi dhe sanimi i mjedisit jetësor, si dhe pastrimi dhe zvogëlimi i sasive të mbeturinave; bujqësi e qëndrueshme; arsim, rregullim, harmonizim ligjor, vetëdija publike dhe trajnime, etj.

Arsimi luan rol të rëndësishëm në gjenerimin e ndryshimeve në sjelljen e individëve ndaj mjedisit jetësor. Nevoja për shkathtësi të reja në procesin e tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër zhvillohet nëpërmjet arsimit dhe politikave arsimore në të gjitha nivelet. Veçoritë e rëndësishme të sjelljes, si vetëdija dhe qëndrimet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor zhvillohen gjatë arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë.

Shkathtësitë e gjelbra janë të nevojshme për të krijuar individë kompetent. Këtë e tregojnë një sërë shembuj dhe përvoja në mbarë botën. Me përfitimin e këtyre shkathtësive, individët bëhen konkurrues me karakteristika të gjelbra dhe shkathtësi për të kontribuar në ruajtjen e baraspeshës ekologjike.

Republika e Maqedonisë së Veriut ballafaqohet me sfidën e zbatimit të reformave serioze në sistemin shoqëror. Në kontekst të këtyre reformave me rëndësi thelbësore për zhvillimin e vendit janë reformat në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe çështja e efikasitetit energjetik. Duke u nisur nga kjo, njëri nga qëllimet themelore hulumtuese në këtë segment ishte analizimi i strategjive, raporteve dhe akteve përkatëse ligjore të veçanta me qëllim që të zbulohet nëse në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë përmbajnë pjesë të cilat mund të jenë të rëndësishme për krijimin e atmosferës për shfaqjen e shkathtësive të gjelbra në vendin tonë.

Fokusi në këtë pjesë të hulumtimit është i drejtuar në analizimin e strategjive nga sfera e ruajtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit të qëndrueshëm, por edhe në strategji tjera të ndërlidhura me këto çështje. Është kryer edhe rishikim edhe drejt strategjive dhe programeve që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, veçanërisht në çështjen e efikasitetit energjetik, fuqisë punëtore dhe punësimit në vendin tonë. Parimi i njëjtë hulumtues është zbatuar edhe në analizën e ak-

teve të veçanta ligjore. Zgjidhja është bërë bazuar në rëndësinë e strategjive dhe akteve ligjore nga aspekti i problematikës së studiuar, domethënë përgatitjen e parakushteve për krijimin e shkathtësive të gjelbra. Nga aspekti i horizontit kohor, analiza merr konsideratë strategjitë dhe dokumentet aktuale, por edhe ato që janë përgatitur gjatë 15-20 viteve të fundit. Përveç kësaj është marrë në konsideratë qëllimi i vendit tonë për integrim dhe anëtarësim në BE, që në parim, reflektohet edhe në dokumentet strategjike dhe aktet ligjore të analizuar të cilat janë përgatitur në pajtim me standardet e BE-së.

Në këtë pjesë të analizës si pikë referimi shërbyen hulumtimet me titull *Skills for green jobs* të realizuara në vitet 2010 dhe 2018 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Qendra Evropiane për Zhvillim të Arsimit Profesional (Cedefop). Në to ishin të përfshira gjashtë shtete anëtare të Bashkimit Evropian: Danimarka, Gjermania, Estonia, Spanja, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar.

Përshtypja e përgjithshme është se në strategjitë, por edhe në ligjet nga problematika përkatëse në vendin tonë, *nuk flitet ose krejtësisht në mënyrë sipërfaqësore dhe të tërthortë është përmendur problematika e shkathtësive të gjelbra*. Sinjale pozitive për ndryshim mund të dallohen në kohë më të re në nismat e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë. Në takimin ministror për arsim dhe trajnim në kuadër të Platformës së sivjetshme për Ballkanin Perëndimor, në fjalimin e tij, ministri për arsim dhe shkencë, Jeton Shaqiri, thekson se nismat për Evropë të gjelbër dhe digjitale janë përfshirë në Konceptin për arsim fillor në vendin tonë, por ato do të përfshihen edhe në Ligjin e ri për Arsim të Mesëm, si dhe në Konceptin për arsim të mesëm.

Mungesa e *shkathtësive bashkëkohore* të fuqia punëtore paraqet faktor që kontribuon në rezultatet modeste në *tregun e punës* në vendin tonë. Ndërmarrja e aktiviteteve të synuara dhe atyre stimuluese nga krijuesit e politikave përkatëse në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të shkathtësive do të kishte kontribut të rëndësishëm në drejtim të rritjes së produktivitetit dhe cilësisë së fuqisë punëtore dhe gjithashtu do të ndihmonte uljen e papunësisë.

Pesëmbëdhjetë vitet e fundit, në shoqërinë maqedonase vërehet interesim i shtuar për çështjet e efikasitetit energjetik (EE) dhe shfrytëzimin e *burimeve të rinovueshme të energjisë* (BRE). Kjo dërgon sinjale pozitive për krijimin e atmosferës për përfitimin e shkathtësive të gjelbra nga fuqia punëtore. Sidoqoftë, ajo është e kufizuar për shkak të ekzistimit të mungesa të caktuar në lidhje me hapjen e çështjes së efikasitetit energjetik (forca e dobët ekonomike e popullit për investime për efikasitet energjetik; drejtësia dytësore e komplikuar për efikasitet energjetik dhe shfrytëzimin e BRE; kapacitete të diskutueshme institucionale; efikasitet i ulët energjetik në prodhimtari, transport, shpërndarje dhe shpenzim të energjisë; si dhe pengesat metodologjike në lidhje me evidentimin e vendeve të gjelbra të punës, si pasojë edhe shkathtësitë e gjelbra si kategori të ndërlidhura). Nga ana tjetër, ekzistojnë mundësi për realizimin e projekteve për *efikasitet energjetik* dhe bazuar në to krijimin e vendeve të gjelbra të punës dhe shkathtësive të gjelbra. Disa nga më të rëndësishmet janë: anëtarësia e Maqedonisë në Bashkësinë energjetike, mundësia për punësime shtesë në sektorin energjetik dhe angazhime të kompanive tjera vendore, fakti që efikasiteti energjetik është e realizueshme nga aspekti ekonomik, si dhe harxhimi i lartë i energjisë elektrike në amvisëri.

Obligimet që do t'i sjellë procesi i negociatave për anëtarësim në BE, do t'i ballafaqojë kompanitë industriale të Maqedonisë me kërkesa të shtuara për korrigjim të ndikimeve të tyre negative ndaj mjedisit jetësor. Përveç kësaj, kompanitë industriale-ndotëse do të duhet të kërkojnë mënyra për efikasitet më të lartë energjetik. Me këtë krijohet mundësia për shkathtësi të gjelbra në këtë sektor.

Gjendja në *ndërtimtari* deri para një kohe të caktuar tregonte interesim të pamjaftueshëm të ndërmarrjeve ndërtimore për rritje të aktiviteteve të tyre në drejtim të EE dhe shtim të shfrytëzimit të BRI. Por, ndërtimtaria edhe më tej mban rolin e një sektori në të cilin ekziston hapësirë domethënëse për krijimin e shkathtësive të gjelbra te fuqia punëtore. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së Maqedonisë është rurale dhe ajo mund të trajnohet me shkathtësi të gjelbra duke ditur synimet e vërtetuara për lëvizjen e zhvillimit të bujqësisë tonë në drejtim të prodhimit organik.

Përvojat ndërkombëtare tregojnë për prani kryesisht të dobët dhe të pamjaftueshme të shkathtësive të gjelbra në arsimin profesional dhe trajnim (APT). Në thelb, kjo është pasojë e mungesës së lidhjes së ATP me politikat e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe strategjitë shtetërore për zhvillim, por edhe mungesës së lidhjes ndërmjet institucioneve për APT dhe ekonomisë. Është bërë hap para me reformat në arsimin e mesëm teknik nga viti 2019 i përkrahur nga Banka Botërore.

Sistemi i arsimit dhe trajnimit profesional duhet të përputhet me rrethanat ekonomike, demografike dhe kulturore. Në këtë kontekst, vlerësimet për zhvillimin e fuqisë punëtore duhet ta ndjekin logjikën e zhvillimit ekonomik lokal (ZhEL). Planifikimi i profileve/kualifikimeve arsimore dhe shkathtësive që do të jenë të nevojshme në të ardhmen duhet të nisë nga nevojat dhe planet zhvillimore lokale. Sigurisht, në këtë kontekst duhet të kyçen edhe shkathtësitë e gjelbra duke ditur se mbrojtja e mjedisit jetësor është segment i rëndësishëm i ZhEL.

Në përditshmërinë komplekse shumë shpesh shfaqen *pengesa* që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e dekurajojnë krijimin e shkathtësive të gjelbra. Pengesat shfaqen si në anën e kërkesës për shkathtësi të këtilla, ashtu edhe në anën e ofertës. Sigurisht, nuk mund të harrohet *shteti* dhe institucionet e saja të cilat me angazhimin e tyre (jo)adekuat mund të ndikojnë në mënyrë dekurajuese. Në anën e kërkesës për shkathtësi të këtilla, si pengesa shumë shpesh paraqitet *mungesa e informacioneve dhe diturisë për rrjedhat aktuale botërore dhe pamundësia për ndjekjen e tyre duke ditur konkurrencën e ulët*. Gjithashtu, *krizat ekonomike dhe recesionet* kanë ndikim negativ ndaj paraqitjes së shkathtësive të gjelbra të reja, sepse çojnë në ndryshimin e prioriteteve të kompanive (janë të detyruara të racionalizojnë shpenzimet e tyre). Prandaj, kriza aktuale ekonomike reflektohet me shkurtimin e shpenzimeve dhe investime të zvogëluara në zhvillimin profesional të të punësuarve te subjektet ekonomike veçanërisht te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pengesë tjetër është *migrimi i fuqisë punëtore në vende tjera, veçanërisht në shtetet fqinje dhe në BE*. Kjo paraqet "eksport" të kuadrit të kualifikuar jashtë shtetit. Më në fund, *ekonomia joformale* po ashtu shfaqet si pengesë në anën e kërkesës, gjë që mund të dekurajojë shfaqjen e shkathtësive të gjelbra, sepse fuqia punëtore, e cila është e angazhuar në ekonominë joformale zakonisht nuk mund të kualifikohet për qasje në trajnime formale të organizuara nga shteti.

Pengesat që mund të paraqiten në *anën e ofertës* së shkathtësive të gjelbra kanë të bëjnë me nënsistemin e arsimit profesional dhe trajnimit. Sistemi arsimor kombëtar në raste të caktuara shfaq nevojën për programe për trajnime shtesë të profesorëve për shkathtësi të veçanta. Gjithashtu, nevojat për trajnim duhet t'i nënshtrohet parashikimit në kuadër të institucioneve përkatëse, ndërsa kjo duhet të jetë rezultat i bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara (institucionet për trajnim dhe arsim, odat dhe shoqatat profesionale, organizatat jo-qeveritare dhe Qeveria). *Bashkëpunimi me biznesin dhe veprimtarët tregtar* mund të ndihmojë në këtë drejtim. Numri gjithnjë më i madh i shembujve të arsimit të dyfishtë që është rezultat i bashkëpunimit të nënsistemit të arsimit të mesëm profesional me odat ekonomike paraqesin vërtetim se bëhet fjalë për një praktikë shumë të rëndësishme.

Qëllimi bazë i hulumtimit të realizuar për „shkathtësitë e gjelbra dhe potenciali i tyre në arsimin e mesëm në Maqedoninë e Veriut“, me theks të veçantë në arsimin e mesëm profesional është identifikimi i mundësive, potencialeve dhe kapaciteteve për përfitimin e shkathtësive për ekonominë e gjelbër (shkathtësi të gjelbra) në vend, si dhe mundësitë për integrimin e tyre në arsimin e mesëm (me fokus në arsimin e mesëm profesional) dhe me këtë të kontribuohet në realizimin e projektit “Inkurajimi i fëmijëve dhe të rinjve në Maqedoninë e Veriut për t’u bërë shtytës të ndryshimit për të zvogëluar ndjeshmërinë e komuniteteve ndaj ndryshimeve klimatike”, i zbatuar nga UNICEF me mbështetje financiare të Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) dhe në partneritet me projektin “Arsim për punësim në Maqedoninë e Veriut”, e financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Qëllimet e veçanta të hulumtimit për “shkathtësitë e gjelbra dhe potenciali i tyre në arsimin e mesëm në Maqedoninë e Veriut”, me theks të veçantë në arsimin e mesëm profesional, janë:

- Të fitohet pasqyrë e përgjithshme për gjendjen aktuale, si dhe të vërehen mundësitë për integrim të shkathtësive të gjelbra në procesin arsimor të arsimit të mesëm profesional.
- Të identifikohet prej nga dalin kualifikimet për shkathtësi të gjelbra, gjegjësisht të bëhet analizë tërësore e përmbajtjeve të programeve mësimore modulare për arsim të mesëm profesional.
- Të fitohen informata për perceptimet, mundësitë dhe nevojat për zhvillim dhe avancim të kualifikimeve për shkathtësi të gjelbra në arsimin e mesëm profesional të institucione të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut (institucione arsimore, institucione shtetërore, OJQ, sektori privat dhe të tjerë).

Pasqyra e përgjithshme e gjendjes aktuale dhe identifikimi i mundësive për integrim të shkathtësive të gjelbra në procesin arsimor në arsimin e mesëm profesional u bë nëpërmjet analizës së kualifikimeve të cilat i arrijnë nxënësit pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Si burim i të dhënave për përpilimin e analizës është shfrytëzuar vëllimi i parë i „Udhërrëfyes nëpër kualifikimet në arsimin e profesional“, i cili përmban informacione për 14 profesione/sectorë për të cilët është kompetente Qendra për arsim profesional dhe trajnim (QAPT). Si konkluzion i përgjithshëm i analizës së kualifikimeve në strukturat e arsimit profesional dyvjeçar, trevjeçar dhe katërvjeçar mund të thuhet se një pjesë e nxënësve janë të kualifikuar me dituri dhe shkathtësi për qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor (shkathtësi të gjelbra) në disa sektorë, gjegjësisht profesione, por jo në të gjitha profilet që janë pjesë e një profesioni.

Identifikimi i asaj se nga burojnë kualifikimet e vërtetuara për shkathtësi të gjelbra, gjegjësisht analizë tërësore e përmbajtjeve të programeve arsimore për arsim të mesëm profesional të përpiluara në mënyrë modulare u bë me zbatimin e teknikës hulumtuese kërkim sipas fjalëve kyçe. Lëndë e analizës ishte përfaqësimi i temave dhe aktiviteteve arsimore në lidhje me qëndrueshmërinë si koncept dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor në programet mësimore të lëndëve mësimore profesionale dhe sa ato përmbajtje janë të përfshira në programet mësimore të ofruara. Kjo qasje metodologjike mundësoi edhe përcaktimin e shkallës së “gjelbërsisë” si në programet individuale mësimore, ashtu edhe në secilin nga profilet e analizuar. Për analizë u përdorën programet mësimore aktuale për arsim të mesëm profesional. Modeli ekzistues sipas të cilit përpilohen programet mësimore për veprimtarinë edukativo-arsimore në arsimin e mesëm profesional mundëson përfitimin e informatave të përgjithshme për integrimin e përmbajtjeve për ekonomi të gjelbër, qëndrueshmëri dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe për përcaktimin e shkallës së “gjelbërsisë”. Me kërkim të fjalëve kyçe dhe vërtetimin e përfaqësimit të tyre në komponentët obligatorë të programit mësimor të lëndës sipas numrit dhe shumëllojshmërisë,

mund të vërtetohet integrimi i përbajtjeve për ekonominë e gjelbër, qëndrueshmërinë dhe mjedisin jetësor, edhe atë integrim nga 1 (i ulët) deri më 5 (i lartë). Pas vërtetimit të përfaqësimit në përqindje të lëndëve në të cilat ka integrim të përbajtjeve për ekonominë e gjelbër dhe qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor në numrin e përgjithshëm të lëndëve profesionale të para-para për profilin/kualifikimin arsimor, mund të përcaktohet shkalla e "gjelbërsisë" së programit mësimor, edhe atë si e ulët, e mesme dhe e lartë. Në analizë janë përfshirë programe mësimore nga gjithsej 18 profile arsimore, gjegjësisht nga një profil nga secili profesion të cilët u vërtetuan kualifikime për shkathtësi të gjelbra gjatë analizës së Udhërrëfyesit. Në veçanti u analizuan gjithsej 351 lëndë mësimore profesionale dhe nivelet e përcaktuara të integritit të përbajtjeve për ekonominë e gjelbër, qëndrueshmërinë dhe mjedisin jetësor që u vërtetuan te 91 lëndë mësimore profesionale. Ilustrimet tabelore të përgatitura për 351 lëndë mësimore profesionale të analizuar dhe nivelet e përcaktuara të integritit të përbajtjeve për ekonominë e gjelbër, qëndrueshmërinë dhe mjedisin jetësor janë shtojca për tekstin bazë dhe janë në dispozicion në: [link](#). Me qëllim të arritjes së qasjes në mundësinë për fitim të kualifikimeve me shkathtësi të gjelbra në arsimin profesional u bë rishikim i programeve mësimore dhe i të gjithë profileve/kualifikimeve tjera arsimore, gjegjësisht profileve/kualifikimeve që nuk ishin pjesë e analizës tërësore. Për shkak të kufizimit kohor, te ata u rishikuan programet mësimore dhe lëndëve të identifikuar të cilët sipas emërimit, por edhe sipas njohurive nga analiza tërësore, tregojnë se ka nivel të mirë (4) dhe të lartë (5) të integritit të përbajtjeve për shkathtësi të gjelbra, qëndrueshmëri dhe mjedis jetësor.

Në përgjithësi, te gjysma e programeve mësimore profesionale është vërtetuar "gjelbërsi" e ulët, ku duhet të kemi parasysh se te profilet arsimore trevjeçare me 62% mbizotërojnë programet mësimore mesatarisht të gjelbra, ndërsa te profilet profesionale katërvjeçare me 80% mbizotërojnë ato me "gjelbërsi" të ulët. Përfundime të ngjashme dolën edhe nga analiza e thellë, gjegjësisht më shumë se gjysma e lëndëve profesionale të analizuar (59 %) janë me nivel të ulët të integritit (1) të përbajtjeve për ekonominë e gjelbër, qëndrueshmërinë, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shkathtësi të gjelbra. Lëndë të cilat sipas emërimit japin shenjë se te ato ka nivel të mirë (4) dhe të fuqishëm (5) të integritit të përbajtjeve për shkathtësi të gjelbra, qëndrueshmëri dhe mjedis jetësor u identifikuan edhe në planet mësimore të profileve. kualifikimeve arsimore që nuk ishin të përfshira në analizën e thellë. Këto informata krijojnë konkluzionin se në arsimin profesional ka potencial për fitimin e kualifikimeve me shkathtësi të gjelbra dhe bazë për integrim të përbajtjeve shtesë për ekonomi të gjelbër, qëndrueshmëri dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

Që të fitohen informata për perceptimet, mundësitë dhe nevojat për zhvillim dhe avancim të kualifikimeve për shkathtësi të gjelbra në arsimin e mesëm profesional te institucione të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut u mblodhën të dhëna parësore nga institucione shtetërore që punojnë në fushën e arsimit (Byroja për zhvillim të arsimit BZHA dhe Qendra për arsim të mesëm profesional dhe trajnim – QAMPT), nga persona të rinj, nxënës të shkollave të mesme profesionale në territorin e shtetit, si dhe në sektorin afarist (punës në kompani private). Si metoda dhe teknika hulumtimi u zbatuan intervista të gjysmë strukturuara, vëzhgim i pa strukturuar dhe hulumtim anketues eksplorues. Shabllonet e përdorura për mbledhjen e të dhënave parësore, si dhe lidhjet nga fjalime publike relevante janë shtojca të tekstit bazë dhe janë në dispozicion në: [link](#).

Si burim i të dhënave për vëzhgimin e pa strukturuar u përdor tribuna me temë "Shkathtësi për qytet të gjelbër", e cila u organizua në kuadër të projektit "Platforma evropiane për të qenë i jashtëzakonshëm në arsimin profesional dhe trajnim për risi të gjelbra - GREENOVET" dhe nisma "Java evropiane e shkathtësive profesionale". Konkluzioni i përgjithshëm nga tribuna ishte se shkathtësitë profesionale janë çelës për tranzicion të gjelbër më të shpejtë të ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi dhe për këtë shkak është e detyrueshme të gjitha palët e prekura të

punojnë në mënyrë aktive dhe intensive në zhvillimin dhe përfshirjen e tyre në programet mësimore dhe proceset arsimore.

Nga intervistat e gjysmë strukturuar të realizuara me përfaqësues të Qendrës për arsim profesional dhe trajnim (QAPT) Byrosë për zhvillim të arsimit (BZhA) u arrit në njohuri dhe informata të vlefshme për mundësitë, potencialet dhe kapacitetet për integrim të përmbajtjeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe shkathtësi të gjelbra në arsimin e mesëm profesional. Domethënë, palët relevante nga pjesa e institucioneve shtetërore që punojnë në fushën e arsimit, në suaza të kompetencave dhe kapaciteteve të veta, në mënyrë të vazhdueshme japin mund për zhvillimin e arsimit të mesëm profesional, veçanërisht në drejtim të lidhjes me tregun e punës.

Hulumtimi eksplorues u realizua nëpërmjet anketës në internet të nxënësve të shkollave të mesme të arsimit të mesëm profesional në territorin e shtetit dhe mundësoi të arrihet në informata të përgjithshme për nivelin e vetëdijes për shkathtësitë e gjelbra, si dhe për perceptimet dhe vlerësimin e kompetencave me shkathtësi të gjelbra nga nxënësit e shkollave të mesme profesionale dhe punëdhënësit. Rezultatet u analizuan në mënyrë krahasuese dhe dhanë tregues relevant për atë se në cilët aspekte duhet të përqendrohen hulumtimet dhe angazhimet e ardhshme për vërtetimin dhe shfrytëzimin e mundësive dhe potencialit për shkathtësi të gjelbra në arsimin e mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Domethënë, te të anketuarit ekziston nivel veçanërisht i lartë i vetëdijes për shkathtësitë e gjelbra, por potenciali për zbatimin e tyre në arsimin profesional nuk është plotësisht i shfrytëzuar.

- Me Qëllimin 14: Arsimi është i rëndësishëm për zhvillimin e vetëdijes për detet dhe ndërtimi i konsensusit në lidhje me shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre.
- Me Qëllimin 15: Arsimi dhe trajnimi shtojnë shkathtësitë dhe kapacitetet për përkrahje të qëndrueshmërisë dhe ruajtjen e burimeve natyrore dhe biodiversitetit, veçanërisht në mjedise të rrezikuara.
- Me Qëllimin 16: Mësimi shoqëror është me rëndësi jetësore për lehtësimin dhe sigurimin e shoqërive pjesëmarrëse, përfshirëse dhe të drejta, si dhe koherencë shoqërore.
- Me Qëllimin 17: Mësimi i përjetshëm ndërton kapacitet për kuptimin dhe promovimin e qëndrueshmërisë.

Shkathtësitë e gjelbra janë të nevojshme për prodhimin e individëve kompetent, në çka tregojnë një sërë shembuj dhe përvoja në shtete të ndryshme. Me fitimin e këtyre shkathtësive, individët bëhen konkurrues me karakteristika të gjelbra dhe shkathtësi për ruajtjen e baraspeshës ekologjike në nivel vendor dhe global.

Sistemi arsimor është platforma më e mirë që mund të përfshijë studim të shkathtësive të gjelbra gjenerike nga nxënësit. Në këtë kontekst, në botë edhe të shtetet në zhvillim ekzistojnë shembuj të shteteve të cilat është bërë hap para në përfshirjen e shkathtësive të gjelbra në arsim edhe pse shfaqet problemi i mospërshtatjes së politikave arsimore dhe ekonomike.

Për shembull, qeveria e Shri Lankës zhvillon politikë proaktive dhe të drejtpërdrejta arsimore dhe ka në dispozicion institucione që përfshijë shkathtësi të gjelbra gjenerike dhe specifike në programet dhe kurset e tyre, si dhe angazhim aktiv me industrinë për të siguruar informatë kthyesë të vazhdueshme për reforma në programet arsimore. Në të njëjtën kohë, pritet që kërkesa për shkathtësi të tilla do të rritet në afat të mesëm dhe të gjatë.

Në Malajzi, për shembull, ekziston plan arsimor me agjendë për zhvillim të kapitalit njerëzor, zbatim dhe zhvillim të teknologjive të gjelbra që avancohen në vazhdimësi, gjë që është me rëndësi thelbësore për përfshirjen e shkathtësive të gjelbra në programet mësimore në arsimin e mesëm. Përmbajtjet e programeve mësimore në të cilat janë përfshirë shkathtësitë e gjelbra duhet të jenë të ndërlidhura me teknologjitë e gjelbra. Roli i shkollave të mesme nuk është vetëm të sigurojnë dituri për nxënësit por edhe të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor në mënyrën më të mirë. (Arasinah et al., 2017, p. 340).

Në Mbretërinë e Bashkuar vendoset sistem i ri për identifikimin e nevojave për shkathtësi dhe artikullimin e tyre si bazë për përgjigjet e arsimit dhe trajnimin në nivel rajonal nëpërmjet agjencive për zhvillim rajonal dhe këshillave të sektorëve për shkathtësi, me qëllim të kuptimit më të mirë të nevojave të industrisë. Mbretëria e Bashkuar ka krijuar Komision për punësim dhe shkathtësi me qëllim të zbatimit të revizionit vjetor të shkathtësive strategjike dhe t'i identifikojë nevojat e punëdhënësve në sektorët me prioritet.

Shembujt e disa shteteve anëtare të BE-së, si Danimarka, Gjermania dhe Estonia tregojnë se zhvillimi i shkathtësive zbatohet në mënyrë efikase nëpërmjet organizimit të kurseve kryesisht akademike dhe profesionale për arsim profesional dhe trajnim, stazh dhe nisma tjera të përfshira në sistemin arsimor formal. Prandaj, për shembull. Në Gjermani, integrimi i aspekteve ekologjike ka ndikim të fuqishëm mbi sistemin gjerman për dhe trajnim gjatë viteve të fundit. Mbrojtja e mjedisit jetësor është e kyçur edhe në trajnimin e dyfishtë profesional (arsimi i dyfishtë) dhe në arsimin e lartë dhe janë krijuar kurse të reja për trajnim fillestar dhe studime universitare.

Në thelb, adoleshentët dhe të rinjtë kanë nevojë për arsimim të vazhdueshëm për qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor dhe për këtë shkak synimi i institucioneve arsimore duhet të jetë edukimi i punonjësve të ardhshëm me njohuri dhe shkathtësi të gjelbra. Pra, për vendet e gjelbra të punës nevojiten shkathtësi dhe njohuri të gjelbra të cilat janë në funksion të zhvillimit të ekonomisë së gjelbër, vetëdijes publike për çështjet ekologjike dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në arsimin e mesëm, më e përshtatshme është nxënësit në fillim të fitojnë njohuri për shkathtësi të gjelbra dhe teknologji të gjelbra para se të kalojnë në nivel më të lartë të arsimit. Kur këta nxënës me shkathtësi të gjelbra do të kalojnë në nivel më të lartë të arsimit, do të jenë të aftë ta zbatojnë atë që kanë mësuar dhe njohuritë t'i shndërrojnë në aktivitete dhe procese që do të rezultojnë me konkurrueshmëri më të lartë të tyre për vende të gjelbra të punës. Përveç njohurive të përgjithshme për shkathtësi dhe teknologji të gjelbra, në arsimin e mesëm profesional, nxënësit duhet të fitojnë edhe shkathtësi të zbatueshme (operative) teknike që do ta rrisin konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës.

Për fat të keq, edhe më tej një përqindje e madhe e nxënësve nuk kanë vetëdije të mjaftueshme ose nuk janë mjaftueshëm të edukuar për problemet dhe sfidat e mjedisit jetësor. Për këtë shkak, është e nevojshme arsimi të përfshihet në zgjidhjen e çështjeve globale për mjedisin jetësor dhe të jep kontribut në ruajtjen e planetit për gjeneratat e ardhshme. Përveç kësaj, duhet të zhvillohet edhe mbështetje mediatike për një sërë çështje të rëndësishme në funksion të edukimit dhe ngritjes së vetëdijes të nxënësit për qëndrueshmërinë, shkathtësitë e gjelbra dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Zhvillimi i shkathtësive është me rëndësi kyçe për rritjen e potencialit për punësim dhe rritjen e gjelbër, por politikat për arsim dhe fitim të njohurive në lidhje me politikat për mjedis jetësor nuk janë të harmonizuara mjaftueshëm. Për këtë shkak, është e nevojshme që qeveritë kombëtare dhe ministrinë për arsim të zhvillojnë strategji për dialog shoqëror dhe koordinim ndërmjet ministrive dhe punëdhënësve dhe ofruesve të shërbimeve për arsim dhe trajnime.¹


¹ https://www.ilo.org/global/publications/books/WCMS_159585/lang--en/index.htm, qasur më datë 04.05.2022.

Nxënësve duhet t'ju ofrohen programe të integruara arsimore ku do të jenë të përfshira përmbajtje me të cilat do të do t'i zhvillojnë dhe plotësojnë shkathtësitë e gjelbra në jetën e përditshme. Bashkë me plotësimin e përmbajtjeve arsimore, qeveritë kombëtare mund t'i promovojnë praktikën e gjelbra, me çka në afat të mesëm do të kontribuonin në zvogëlimin e materialeve dhe prodhimeve jo ekologjike, si stiropori, enët plastike që nuk janë ekologjike, shfrytëzim minimal i qeseve të plastikës dhe të ngjashme.

Në arsimin e mesëm profesional, duhet të krijohen dhe të integrohen përmbajtje nga ekologjia nëpërmjet procesit të edukimit teorik dhe praktik dhe zbatimit të metodave eksperimentale të mësimin, veçanërisht në pjesën që zhvillohet në kompanitë/punëdhënësit që do ta rrit karakteristiken novatore të nxënësve. Me qasje të tillë në krijimin dhe zbatimin e programeve arsimore, nxënësit bëhen më të vetëdijshëm për dobinë e burimeve ekzistuese dhe të aftësuar që vetë t'i integrojnë në profesionet e ardhshme në mënyrë kreative. Pra, për shembull, njohuritë dhe praktikën për riciklim të materialeve të shfrytëzuara janë përmbajtje veçanërisht të rëndësishme që është e nevojshme të zhvillohen te nxënësit. Riciklimi i materialeve që nuk përdoren mund ta ruajë mjedisin jetësor dhe të ndihmojë në zbatimin e praktikave të gjelbra në jetën e përditshme.

Njohuritë për shkathtësitë e gjelbra do të kontribuojnë në krijimin e kapitalit njerëzor me arsim të lartë i cili me aktivitetet e tij do të ketë ndikim mbi rritjen e qëndrueshme dhe teknologjitë e gjelbra. Këto shkathtësi janë të nevojshme për edukimin dhe shkathtësimin e fuqisë punëtore e cila do të mund t'i përkrahë kushtet shoqërore, ekonomike dhe ato të mjedisit për zhvillim të biznesit, ekonomisë dhe shoqërisë. Në fitimin e shkathtësive të gjelbra duhet të kyçet secili individ, prodhim, shërbim ose proces për zvogëlimin e problemit të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor sipas kërkesave dhe rregullave specifike të mirësjelljes. (Sarsvathy, Ramlee, 2020, p. 164).

Është e nevojshme që qeveritë kombëtare të ndërmarrin nisma në lidhje me praktikën e gjelbra. Përkushtimi në drejtim të rritjes së pastër dhe "të gjelbër" kërkon profesionistë "të gjelbër" në fusha të ndryshme të cilët në procesin e arsimit do të aftësohen për adoptimin e këtyre praktikave si mënyrë jete. Për fat të keq, institucionet arsimore në më shumë vende ende nuk kanë strategji efektive për vende të gjelbra pune dhe nuk janë përgjigjur në sfidat për shkathtësitë në lidhje me çështjet ekologjike dhe ndryshimet klimatike dhe si pasojë e kësaj, nuk kanë zhvilluar aktivitete të koordinuara për arsim, shkathtësim dhe përgatitje të fuqisë punëtore për shkathtësi të gjelbra.



Nëntor 2022